

Victor A. Friedman, Chicago

**NDIKIMI I SHQIPES NË TË FOLMET ARUMUNE
TË MAQEDONISË JUGPERËNDIMORE:
MËNYRA HABITORE**

Sipas Wilfried Fiedlerit (1968: 131), në gjuhën arumune ndeshen forma të mënyrës habitore apo përdorime foljore të ngjashme (gjermanisht Admirativ-Kommentativsystem), gjë që ngjet në disa gjuhë ballkanike të tjera, si shqip, maqedonisht dhe bullgarisht. Tek Atanasov (1990: 220) lexojmë se në gjuhën megleno-rumune kemi një të kryer të përmbysur (perfekt të përmbysur) me foljen ndihmëse prapa pjesores dhe me kuptime të ngjashme me të mënyrës habitore të shqipes apo me të përdorimeve jovepruese (habi, dyshim, ritregim) të maqedonishtes dhe të bullgarishtes, siç shihet në shembullin e parë:

(1) **ă bră, tu fost-ăi mări om!**

a be, ti si bil golem čovek!

'mais je viens d'apprendre que tu es une personne importante!' (Atanasov 1990:221)

ore, ti qenke njeri i madh!

Këtu fjala **fost** është pjesore dhe **ăi** është folje ndihmëse. E kryera normale megleno-rumune do të ishte **ăi fost**. Paralelja morfologjike me gjuhën shqipe bie në sy, por megjithatë është krejtësisht e mundshme që këtu të kemi të bëjmë me një tendencë tipologjike dhe jo me kontakt midis shqipes dhe megleno-rumanishtes. Edhe pse dimë se në shekujt e shkuar shqiptarët kanë mërguar nëpër Meglen në rrugën e tyre për vende të tjera, nuk kemi evidencë më të saktë. Prandaj nuk mund të themi më shumë për prejardhjen e së kryerës së përmbysur në megleno-rumanishten.

Sidoqoftë, deri tani arumanishtja është dukur si një ishull gjuhësor (më saktë si një arqipel) në Ballkanin Qendror, në të cilin jovërtetimi nuk shprehet me kategori foljore (shih. Goab 1984). Përveç arumanishtes, gjuhët në këtë zonë (shqip,

maqedonisht, bullgarisht dhe meglëno-rumanisht) e kanë këtë kategori, e cila, përmes turqishtes, i lidh me zonën linguistike më të gjerë të Evrazisë, që karakterizohet me shfaqjen e kundërvënies të tilla të "statusit" (shih Friedman, 1979, 1988). Mirëpo, kur isha në Ohër (Republika e Maqedonisë) më 1992, gjeta se në të folmen arumune të Belicës (maq. Belica, arum. Beal) ndeshet një formë foljore jovërtetuese, që funksionon si habitorja e shqipes dhe disa përdorime të formës foljore me -I të maqedonishtes, siç shihet në shembullin e dytë:

(2) **Mi l'oi di minti: "A be tora tini fuskă avut om!"**

Se šašardisav: "A be sega ti si bil bogat čovek!"

U habita: "Ore, tani qenke njeri i pasur!"

Kur kemi parasysh faktin se deri në kohë të vona banorët e Belicës dinin shqip dhe se së paku një pjesë e tyre kishte ardhur më përparpa nga Shqipëria, duket se kjo habitore arumune u formua përmes një analizimi abduktiv të habitores së shqipes. Siç dihet, në gjuhën shqipe habitorja është formuar prej një perfekti të përmbysur të tipit pjesore + folje ndihmëse, për shembull: **ai ka qenë** → **ai qenka**. Në këtë të folme të arumanishtes duket se morfema **-ka**, që në shqipen shënon vetën e tretë të habitores, do të jetë kuptuar si shenjë e habitores në përgjithësi dhe do të jetë lidhur me pjesoren arumune kështu: ***fustà + ka** → **fuskă**, që përdoret për çdo vetë dhe me shumë folje. (Nryshimi i tingullit / a / në / ă / mund të ketë dalë nga ndikimi i pjesores, po mund të jetë edhe tipar dialektor).

Kjo dukuri ka kuptime më të gjera. Një çështje qendrore në diskutimet mbi prejardhjen e kategorive të jovërtetimit në gjuhët e Ballkanit është pyetja a ishin këto kategori kalke të drejtpërdrejta nga turqishtja, domethënë nga perfekti me sufiksin **-mis**, apo ishin trajta autoktone, të cilave turqishtja ndoshta u kishte dhënë shtysë të zhvilloheshin më tej. Demiraj (1971) ka shkruar për moshën e habitores në gjuhën shqipe, ndërsa Friedman (1978) ka paraqitur evidenca për një fillim autokton edhe në gjuhët ballkano-sllave. Ky diskutim ka lidhje me pyetjen më të gjerë rreth tendencës që perfektat të zhvillohen në trajtat që janë të markuara për "statusin". Megjithëse për dukurinë e habitores në arumanishte nevojitet një gjurmim më i thellë e më i hollë, megjithatë, dëshmia që dhamë këtu është më tepër se një shembull interesant i një morfeme gramatikore që ishte huazuar (**-ka** shqipe në arumanishte), i një kalku ballkanik (përdorimi i pjesores si bazë), si dhe kundërpërgjigje për mendimin se në arumanishte mënyra habitore nuk ekziston. Kemi këtu një dëshmi krejtësisht të padyshimtë, në të cilin kategoria e "statusit", domethënë kategoria jovërtetuese e habitores, është huazuar, dhe është huazuar nga gjuha shqipe.

Bibliografia:

- Atanasov, P. 1990. *Le mégléno-roumain de nos jours*. Hamburg: Buske.
- Demiraj, Sh. 1971. "Haborja dhe mosha e saj". *Studime filologjike* 8,3. 31-49.
- Fiedler, W. 1968. "Das aromanische Verbalsystem in balkanologischer Sicht". *Beiträge zur rumänischen Philologie*. Berlin: Akademie-Verlag.
- Friedman, V. 1978. "On the Semantic and Morphological Influence of Turkish on Balkan Slavic". *Papers from the Fourteenth Regional Meeting: Chicago Linguistic Society*. Chicago: Linguistic Society, 108-18.
- Friedman, V. 1979. "Toward a Typology of Status: Georgian and other non-Slavic Languages of the Soviet Union". *The Elements: A Parasession on Linguistic Units and Levels*, Chicago: Chicago Linguistic Society. 339-50.
- Friedman, V. 1988. "The Category of Evidentiality in the Balkans and the Caucasus". *American Contributions to the Tenth International Congress of Slavists: Linguistics*. Columbus: Slavica. 121-139.
- Golamb, Z. 1984. *The Arumanian Dialect of Kruševo in SR Macedonia SFR Yugoslavia*. Skopje: MANU.

Victor A. Friedman, Université de Chicago

L'INFLUENCE DE L'ALBANAIS SUR LES PARLERS AROUMAINS DE LA MACEDOINE DU SUD-OUEST: MODE ADMIRATIF

Résumé

Bien qu'il soit nécessaire de faire une étude approfondie sur le phénomène de l'admiratif en aroumain, l'argument qu'on donne ici est plus qu'un exemple intéressant. L'auteur a noté en megléno-roumain:

ă bră, tu fost-ăi mări om!

a be, ti si bil golem čovek!

ore, ti qenke njeri i madh!,

tandis qu'à Ohër (Ohrid) en 1992, dans le parler aroumain de Belicë, l'auteur a rencontré une forme verbale non vérifiée, qui fonctionne comme l'admiratif albanais et quelques emplois de la forme verbale en -I du macédonien, comme on peut voir dans l'exemple ci-dessous:

Mi l'oi di minti: "A be tora tini fuskă avut om!"

Se šašardisav: "A be sega ti si bil bogat čovek!"

U habita: "Ore, tani qenke njeri i pasur!"

Il ressort de cet exemple que la catégorie non vérifiée de l'admiratif est empruntée à l'albanais.

En dehors de l'aroumain, les langues de cette région (albanais, macédonien, bulgare et megléno-roumain) sont liées avec une aire linguistique plus vaste de l'Euro-Asie.